



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1918 prot.

Tiranë më, 31.12.2020

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 18, datë 31.12.2020

PËR

**MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURIALE PËR VERIFIKIMIN E TË
DHËNAVE TË FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT NGA STRUKTURA E
POSAÇME NË ZBATIM TË LIGJIT NR.138/2015¹ DHE VENDIMIT NR.17/2016² TË
KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të, neneve 148 pika 1 e 148/b shkronja “b” e “dh” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 38, pika 2, shkronja “b” e “k” dhe 46 pika 3 shkronja “ç” të ligjit nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 2, 3, 5, 7, 8 e vijues të ligjit nr.138/ 2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, kreu V, e vijues i vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr.17, datë 04.03.2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike””, Kodit të Procedurës Administrative, dhe Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë datë 18.06.2020³;

U D H Ë Z O J:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi

¹Ligji nr.138/ 2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

²Vendimi i Kuvendit të Shqipërisë nr. 17, datë 04.03.2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

³ Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë datë 18.06.2020 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2019”, e cila parashikon: “...për vitin 2020 Kuvendi i Shqipërisë kërkon nga Prokuroria e Republikës së Shqipërisë: “6. Të miratojë udhëzimin e standardizuar për zbatimin e ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike””.

1. Ky udhëzim i përgjithshëm ka për qëllim të unifikojë masat administrative dhe procedurale për verifikimin e të dhënave të formularit të vetëdeklarimit, mbi kërkesën e organit kompetent drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, në zbatimin e ligjit nr.138/ 2015 dhe vendimit nr.17, datë 04.03.2016 të Kuvendit të Shqipërisë, (në vijim të këtij udhëzimi vendimi nr.17/2016), duke garantuar zbatimin e procesit të rregullt ligjor, dhe parimet e ligjshmërisë, transparencës, informimit, drejtësisë, paanësisë, mbrojtjes së të dhënave personale, konfidencialitetit dhe të sekretit shtetëror.

Neni 2 Objekti

1. Objekt i këtij udhëzimi të përgjithshëm janë:

1.1 Përcaktimi i masave administrative, për kërkesat e organit kompetent drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, sipas ligjit nr.138/2015 dhe vendimit të Kuvendit nr.17/2016:

a) për regjistrimin⁴ dhe caktimin/ndarjen e kërkesave të ardhura/depozituara në Prokurorinë e Përgjithshme nga organet kompetente/përgjegjëse sipas këtij ligji, si dhe personat e përfshirë në procesin e verifikimit;

b) për ruajtjen e dokumentimin në sistemin elektronik⁵ dhe në arkivë të akteve të strukturës së posaçme/sektori i dekriminalizimit;

c) për informimin, koordinimin, monitorimin dhe raportimin lidhur me ecurinë e procesit të verifikimit dhe për mënyrën e përfundimit të procedimeve penale dhe/ose gjykimeve që kanë qenë objekt shqyrtimi në strukturën e posaçme/sektoresh dekriminalizimit;

ç) bashkëpunimi me organet dhe subjektet ligjzbatuese gjatë procesit të verifikimit të kërkesave të organeve kompetente/përgjegjëse.

1.2 Përcaktimi i masave procedurale për verifikimin e të dhënave të formularit të vetëdeklarimit, mbi kërkesën e organit kompetent drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, sipas ligjit nr.138/2015 dhe vendimit të Kuvendit nr.17/2016:

a) për verifikimin paraprak dhe shqyrtimin⁶ e kërkesës për verifikim, lidhur me përmbushjen apo jo të kriterëve formale ligjore dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji⁷;

b) për kryerjen e verifikimit të thelluar të të dhënave të formularit të vetëdeklarimit të kërkuar sipas ligjit;

c) për afatin e procesit të verifikimit të vetëdeklarimeve dhe procedura që ndiqet për zgjatjen e afatit në rastet e veçanta sipas ligjit dhe vendimit të Kuvendit;

ç) për përfundimin e procesit të verifikimit dhe miratimin e rezultateve të verifikimit, si dhe njoftimin e organit kërkues/përgjegjës dhe sipas rastit, subjektin përkatës sipas ligjit.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë udhëzim, termat/emërtimet kanë kuptimet si më poshtë:

⁴ Shih, Kreu VII pika 2/b e Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë;

⁵ Shih, po aty, Kreu VII pika 2/c i Vendimit dhe kreu V pika 8.

⁶ Shih, po aty pika 3 neni 7 i ligjit 138/2015.

⁷ Shih, ligjin nr.138/2015.

1. “Strukturë/sector i posaçëm” është Sektori i Dekriminalizimit në Drejtorinë e Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme, i cili ka kompetenca dhe është përgjegjës për zbatimin e ligjit nr.138/2015⁸ dhe vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.17/2016.

2. “Prokuror i deleguar”, është prokurori i Sektorit të Dekriminalizimit në Drejtorinë e Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilit Prokurori i Përgjithshëm me urdhër të veçantë⁹ i ka deleguar dhe autorizuar kompetencat për zbatimin e ligjit nr.138/2015 dhe vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.

3. “Shef Sektori i deleguar”, është prokurori/shef i Sektorit të Dekriminalizimit në Drejtorinë e Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilit Prokurori i Përgjithshëm me urdhër të veçantë¹⁰ i ka deleguar dhe autorizuar kompetenca për zbatimin e ligjit nr.138/2015 dhe vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.

4. “Drejtor i deleguar”, është prokurori/drejtor i Drejtorisë së Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilit Prokurori i Përgjithshëm me urdhër të veçantë¹¹ i ka deleguar dhe autorizuar kompetencat për zbatimin e ligjit nr.138/2015 dhe vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.

5. “Organe kompetente/përgjegjëse që kërkojnë verifikimin sipas ligjit¹²”, janë:

a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të zgjedhurit dhe kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë apo në organet e qeverisjes vendore;

b) Kryetari i Kuvendit për kandidatët për funksione në organet kushtetuese apo të krijuara me ligj dhe që zgjidhen nga Kuvendi;

c) Prefekti i qarkut përkatës për personat që emërohen në funksione publike me votim nga këshilli bashkiak nën juridiksionin e prefektit apo nga këshilli i qarkut përkatës;

ç) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për anëtarët e Këshillit të Ministrave që nuk kanë mandat deputeti dhe nuk kanë paraqitur vetëdeklarim, sipas shkronjës “a” të kësaj pike;

d) Titullari apo organi që bën emërimin për funksionarin publik që emërohet sipas shkronjës “a”¹³, të pikës 1, të nenit 3 dhe kur ky emërim është i ndryshëm nga funksionet e zgjedhura me votim nga Kuvendi, si dhe kur emërimi bëhet sipas shkronjave “d”¹⁴, dhe “g”¹⁵, të pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr.138/2015;

dh) Kryeministri, për rastet e parashikuara nga shkronjat “c”¹⁶ dhe “ç”¹⁷, të pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr.138/2015;

⁸ Shih, pikën 3 të nenit 15 të Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme” të miratuar me urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.136/2020.

⁹ Shih, urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.42/2020 “Për delegimin dhe autorizimin e kompetencave në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zhjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

¹⁰ Shih, po aty, urdhërin nr.42/2020;

¹¹ Shih, po aty, urdhërin nr.42/2020;

¹² Shih, nenin 8 pika 1 në lidhje me nenin 5 pika 4 e vijues të ligjit nr.138/2015;

¹³ Shih, nenin 3 të ligjit nr.138/2015, i cili në pikën 1 shkronja “a” parashikon: “1. Për veprat penale të parashikuara në pikën 1, të nenit 2, të këtij ligji, personi nuk mund të emërohet apo zgjidhet në funksionet publike si më poshtë: a) në organe kushtetuese apo të krijuara me ligj;”

¹⁴ Shih, nenin 3 të ligjit nr.138/2015, i cili në pikën 1 shkronja “d” parashikon: “d) funksionarë politikë në kabinetet e drejtuesve të çdo institucioni kushtetues apo të krijuar me ligj;”

¹⁵ Shih, nenin 3 të ligjit nr.138/2015, i cili në pikën 1 shkronja “g” parashikon: “g) në çdo post drejtues të kompanive që zotërohen plotësisht apo në maxhorancë ose administrohen nga shteti;”

¹⁶ Shih, nenin 3 të ligjit nr.138/2015, i cili në pikën 1 shkronja “c” parashikon: “c) në postin e zëvendësministrit apo të njëvlershëm me të;”

¹⁷ Shih, nenin 3 të ligjit nr.138/2015, i cili në pikën 1 shkronja “ç” parashikon: “ç) në postin e prefektit;”

e) Drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror apo Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, sipas rastit, për shkronjat “dh”¹⁸ dhe “ë”¹⁹, të pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr.138/2015;

ë) Departamenti i Administratës Publike, për rastet e parashikuara nga shkronja “e”²⁰, e pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr.138/2015;

f) Ministri i Mbrojtjes, për rastet e parashikuara në shkronjën “f”²¹, të pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr.138/2015;

g) Një parti politike për kandidat²² të mundshëm të saj, në zgjedhje apo organe kushtetuese apo të krijuara me ligj, vetëm me pëlqimin e shtetasit, subjekt i verifikimit paraprak.

6. “Verifikim paraprak” është shqyrtimi i kërkesës për verifikim me gjendjen e akteve të dërguara nga organi kompetent/përgjegjës, dhe vlerësimi i kërkesës lidhur kushtet dhe kriteret formale ligjore dhe/ose çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji për fillimin e procedurës së verifikimit.

7. “Verifikim i plotë/thelluar” është kryerja e veprimeve për verifikimin e plotë e të gjithanshëm të të dhënave të formularit vetëdeklarues, objekt kërkesë, lidhur me çdo të dhënë apo dokument pranë organeve shtetërore apo personit juridik, publik apo privat, brenda vendit apo jashtë vendit, në zbatim të kërkesave të parashikuara në ligjin nr.138/2015 dhe vendimin e Kuvendit nr.17.2016.

8. “Përfundim i procesit të verifikimit” është shqyrtimi dhe vlerësimi përfundimtar i veprimeve verifikuese, marrja e vendimit për përfundimin e procesit të verifikimit sipas rastit nga prokurori i deleguar apo shefi sektorit i deleguar dhe miratimi i rezultateve të tij nga Prokurori i Përgjithshëm.

KREU II MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 4

Kërkesa për verifikim, administrimi i saj dhe personat e përfshirë në procesin e verifikimit

1. Verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit sipas ligjit²³ fillon mbi kërkesën e ardhur në Prokurorinë e Përgjithshme nga organi kompetent/përgjegjës sipas ligjit²⁴ ose sipas pikës 1 të nenit 3 të këtij udhëzimi.

2. Kërkesa për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit regjistrohet menjëherë në regjistrin përkatës, dhe dokumentohet e administrohet në sitemin elektronik të strukturës së posaçme.

3. Brenda 2 (dy) ditëve nga regjistrimi i kërkesës zhvillohet procedura e ndarjes/caktimit të kërkesës së ardhur për verifikim, sipas rastit, nga drejtori i deleguar, i cili cakton shefin e

¹⁸ Shih, nenin 3 të ligjit nr.138/2015, i cili në pikën 1 shkronja “dh” parashikon: “*dh*) në Shërbimin Informativ Shtetëror dhe shërbime të tjera informative;”

¹⁹ Shih, nenin 3 të ligjit nr.138/2015, i cili në pikën 1 shkronja “ë” parashikon: “*ë*) në Policinë e Shtetit;”

²⁰ Shih, nenin 3 të ligjit nr.138/2015, i cili në pikën 1 shkronja “e” parashikon: “*e*) në shërbimin civil dhe shërbimin diplomatik si dhe drejtues të çdo niveli ne administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihet në shërbimin civil;”

²¹ Shih, nenin 3 të ligjit nr.138/2015, i cili në pikën 1 shkronja “f” parashikon: “*f*) ushtarakë të forcave të armatosura;”

²² Shih, nenin 7 pika 5 të ligjit nr.138/2015;

²³ Shih, nenin 5 pika 4 shkronjat “a” deri “f” në lidhje me nenet 2 e 3 të ligjit nr.138/2015;

²⁴ Shih, nenin 8 pika 4 shkronjat “a” deri “f” në lidhje me nenet 2 e 3 të ligjit nr.138/2015;

sektorit të deleguar apo prokurorin e deleguar, ose nga shefi i sektorit të deleguar, i cili cakton prokurorin e deleguar të kësaj strukture.

4. Në procesin e verifikimit të kërkesës prokurori i deleguar, drejton procesin e verifikimit dhe ka në dispozicion, specialistin jurist dhe/ose oficerin e policisë gjyqësore të strukturës së posaçme.

Neni 5

Sistemi elektronik, administrimi i akteve dhe arkivimi

1. Në strukturën e posaçme është krijuar dhe funksionin sistemin elektronik²⁵, në të cilin administrohen dhe ruhen të gjitha të dhënat, aktet apo faktet e pasqyruara në dokumentet përkatës gjatë procedurës, dhe rezultatet e verifikimit të dokumentuara në aktin përkatës, duke regjistruar çdo material/praktikë të ardhur/dorëzuar dhe inventarizuar, që nga momenti i ardhjes/marrjes në dorëzim të kërkesës për verifikim në Sektorinë e Protokoll-Arkivit të Prokurorisë së Përgjithshme, dhe çdo lëvizje të praktikës brenda apo jashtë strukturës/sektorit të posaçëm.

2. Në strukturën e posaçme, krahas sistemit elektronik, administrohet dhe një regjistër i posaçëm manual i dokumentimit të kërkesave për verifikim, duke hedhur në regjistër, çdo kërkesë të paraqitur pranë Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe të dhënat sipas rubrikave në regjistër që pasqyrojnë fazat, mënyrat e zgjidhjes ligjore të kërkesës dhe afatet gjatë gjithë procesit të verifikimit të të dhënave të formularëve të vetëdeklarimit të personave që kandidojnë për t'u zgjedhur apo emëruar në një funksion publik, në zbatim të ligjit nr.138/2015 dhe vendimit të Kuvendit nr.17/2016.

3. Dokumentet dhe aktet procedurale të administruara gjatë procedurës së verifikimit, pas inventarizimit në dosje të veçanta, për çdo person të verifikuar, dhe pas nënshkrimit, sipas rastit nga drejtori i deleguar ose shefi i sektorit të deleguar në strukturën e posaçme sipas ligjit "Për arkivën", dërgohet në arkivën e Prokurorisë së Përgjithshme. Ky veprim dokumentohet dhe në regjistrin përkatës.

Neni 6

Informimi, koordinimi, monitorimi dhe raportimi

1. Drejtori i deleguar ose shefi i sektorit të deleguar në strukturën e posaçme, sipas rastit, kërkon informacion²⁶ nga prokurori i deleguar lidhur me ecurinë e verifikimit të të dhënave në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të caktuara dhe mënyrën e zgjidhjes ligjore në përfundim të procesit të verifikimit, si dhe për problematika, pengesa apo vonesa, nga organet shtetërore apo persona juridik publik ose privat, që janë evidentuar në ecurinë e verifikimeve në raste të veçanta.

²⁵ Shih, pikën 3 të nenit 8 të ligjit nr.138/2015 dhe pikën 8 KREU V dhe shkronjës "c" pika 2 e KREU VII të vendimit të Kuvendit nr.17/2016.

²⁶ Shih, nenit 52 "Drejtimi administrativ i prokurorisë", të ligji 97/2016, i cili në pikën 2 parashikon: "2. Prokurorët kanë detyrimin të informojnë drejtuesin e prokurorisë, sa herë që kërkohet prej këtij të fundit, lidhur me punën mbi çështje të caktuara dhe vendimmarrjen, si dhe, në raste të veçanta, për problematika që shfaqen në ecurinë e procedimit."

2. Shefi i sektorit/strukturës së posaçme i deleguar, sipas rastit, informon²⁷ Drejtorin e deleguar dhe/ose Prokurorin e Përgjithshëm, mbi ecurinë dhe problemet e konstatuara gjatë procesit të verifikimit që ndiqen nga struktura e posaçme, sipas parashikimit në pikën 1 të këtij neni.

3. Përfaqësuesi i strukturës së posaçme, sipas rastit, drejtori i deleguar ose shefi i sektorit i deleguar, në koordinim me strukturat e tjera në Prokurorinë e Përgjithshme, kërkon dhe administron periodikisht (çdo 3-mujor, 6-mujor, 9-mujor dhe vit) informacion në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm lidhur me mënyrën e përfundimit të procedimeve penale dhe/ose gjykimeve, për kallëzimet penale të bëra nga organet kompetente/përgjegjëse ndaj subjekteve të ligjit nr.138/2015, të cilët kanë qenë objekt verifikimi në strukturën e posaçme.

4. Drejtori i deleguar dhe/ose shefi i sektorit i deleguar kontribuojnë në përgatitjen e raportit të posaçëm periodik vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme në Kuvendin e Shqipërisë, dhe/ose në përgatitjen e materialit për raportim para Këshillit për Rregulloren dhe Mandatet të Kuvendit të Shqipërisë, lidhur me ecurinë e verifikimit të të dhënave në formularët e vetëdeklarimeve të kërkuara nga organet kompetente, mënyrën e zgjidhjes ligjore dhe problematikat përkatëse të tyre, në zbatim të ligjit²⁸.

Neni 7

Bashkëpunimi me organet dhe subjektet ligjzbatuese

1. Drejtori i deleguar, shefi i sektorit i deleguar dhe/ose prokurori i deleguar sipas përcaktimit në ligj²⁹ dhe në nenin 3, pikat 2, 3 e 4, të këtij udhëzimi, për verifikimin e të dhënave, fakteve dhe rrethanave të vetëdeklaruarra prej shtetasve/subjekteve objekt verifikimi, në cilësinë e përfaqësuesve të strukturës së posaçme në Prokurorinë e Përgjithshme bashkëpunojë me çdo organ shtetëror apo person juridik, publik apo privat për zbatimin e detyrimeve ligjore.

2. Në kuadrin e këtij bashkëpunimi kërkesat e strukturës së posaçme bëhen sipas përparësive, me afat të përcaktuar për kthimin e përgjigjes, sipas objektit të kërkesës, lidhur me subjektet që i nënshtrohen procedurës së verifikimit në zbatim të këtij ligji.

3. Në kërkesat drejtuar organeve dhe subjekteve ligjzbatuese të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, citohet paralajmërimi për përgjegjësinë penale sipas parashikimit ligjor³⁰:

“Mosbashkëpunimi apo refuzimi për të bashkëpunuar, pengesa, vonesa apo keqdrejtimi në procesin e verifikimit përbën vepër penale, në përputhje me nenin 248 të Kodit Penal.”

KREU III MASAT PROCEDURALE

Neni 8

Verifikimi paraprak i kërkesës

²⁷ Shih, po aty pika 2 e nenit 52;

²⁸ Shih, nenin 8 të ligjit nr.138/2015, i cili në pikën 12 parashikon: “12. Prokuroria e Përgjithshme bën raportim të posaçëm dhe të hollësishëm në Kuvend, në kuadër të raportimit vjetor mbi verifikimet, në zbatim të këtij ligji, dhe rezultatet e tyre. Me kërkesë të 1/10 së deputetëve ose të 1/3 së anëtarëve të Këshillit për Rregulloren dhe Mandatet të Kuvendit, Prokuroria e Përgjithshme raporton para këtij komisioni mbi verifikimet, në zbatim të këtij ligji, dhe rezultatet e tyre.”

²⁹ Shih, nenin 9 të ligjit nr.138/2015;

³⁰ Shih, po aty, fjalia e dytë e nenit 9 të ligjit nr.138/2015;

1. Me marrjen e kërkesës për verifikim, prokurori i deleguar, menjëherë verifikon paraprakisht kërkesën dhe aktet/dokumentet bashkëlidhur, si dhe vlerëson nëse kërkesa është në zbatim të kushteve dhe kritereve ligjore që lidhen me kompetencën e organit përgjegjës kërkuar, legjitimitimin, afatin, formën, ekzistencën e aktit objekt verifikimi, dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji³¹.

2. Në këtë fazë verifikimi paraprak të kërkesës, veç sa më sipër, realizohen dhe procedurat standarde, sipas rastit, njoftimi me shkrim menjëherë:

a) i drejtuesit përkatës kur vërehet pengesa ligjore e konfliktit të interesit³² për trajtimin e kërkesës objekt shqyrtimi, si për prokurorin e deleguar, ashtu dhe/ose për personat e përfshirë, specialisti jurist apo oficeri i policisë gjyqësore;

b) i organit kompetent/përgjegjës, për plotësimin e të metave të kërkesës lidhur me kriteret formale ligjore, brenda një afati të arsyeshëm, duke ndihmuar organin kompetent/përgjegjës për plotësimin e saj;

c) i organit kompetent/përgjegjës për plotësimin e të metave të kërkesës dhe/ose kryerjen e veprimeve të mëtejshme plotësuese të saj sipas ligjit, brenda një afati të arsyeshëm.

3. Sipas rastit, specialisti jurist ose oficeri i policisë gjyqësore, bazuar në gjetjet, brenda 10 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës, përgatit relacionin përkatës për verifikimin paraprak të kërkesës objekt verifikimi.

4. Prokurori i deleguar, në përfundim të verifikimit paraprak, shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe çdo akt, informacion dhe të dhënë tjetër të dërguar nga organi kompetent/përgjegjës dhe, kur ekzistojnë kushtet dhe kriteret për kryerjen e verifikimit, përgatit planin/urdhërin për kryerjen e verifikimit të thelluar të të dhënave në formularin e

³¹ Shih, nenin 8 në lidhje me nenet 5, 7, 3, 2 e vijues të ligjit nr.138/2015 dhe vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.

³² Shih, nenin 51 "Shmangia e konfliktit të interesit" të ligjit nr.97/2016 dhe nenet 3 e 4 të ligjit nr.9367/2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, që parashikojnë:

i) Ligji nr.97/2016 në nenin 51 parashikon: "Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, prokurorët detyrohen të shmangin çdo konflikt interesi, sipas rregullave të parashikuara nga legjislati në fuqi. ";

ii) Ligji nr.9367/2005 në:

-Neni 3 "Përkufizime", janë parashikuar kuptimi dhe interpretimi i termit "Konflikt interesi" dhe termat e tjerë si më poshtë:

"1. "Konflikt i interesit" është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike..."

"4. Konflikti i interesit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përfshin disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:

a) "konflikt faktik i interesit" është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij zyrtare;

b) "konflikt në dukje i interesit" është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësi të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë;

c) "konflikt i mundshëm i interesit" është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara;

c) "konflikt rast për rast i interesit" është gjendja me konflikt interesi, në njërin nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë:..."

-Neni 4 "Fusha e zbatimit" parashikon, "1.Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë rregulla të detyrueshme për t'u zbatuar nga: a) çdo zyrtar, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për: ...ii) akte të organeve gjyqësore,...dhe akte të organeve të prokurorisë;..."

-Nërsa neni 5 "Interesa private" parashikon se "1. Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përrputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: ...dh) marrëdhënie: i) familjare apo të bashkëjetesës;

vetëdeklarimit të subjektit përkatës, duke përcaktuar personat e ngarkuar dhe afatet për kryerjen e tyre.

Neni 9

Verifikimi i të dhënave të formularit të vetëdeklaruar

1. Prokurori i deleguar, planifikon dhe urdhëron kryerjen, sipas rastit, të gjithë veprimet verifikuese të përcaktuara, në zbatim të të ligjit³³, referuar procedurave standarde të verifikimit, duke kërkuar informacion dhe dokumentacionin e nevojshëm në organet apo institucionet e listuara, si më poshtë:

a) Drejtorinë e Gjendjes Civile për të konfirmuar të dhënat për gjeneralitetet e përdorura, identitetin fizik si dhe ndryshimet e tyre;

b) Drejtorinë e Gjendjes Gjqësore për të përcaktuar statusin, dënuar apo jo, si dhe dënime penale me vendim të formës së prerë;

c) Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit lidhur me qënien, të arrestuar apo ndaluar, me të dhëna të tjera gjeneralitetesh ose identitetesh, si dhe qënien ose jo, në kërkim ndërkombëtar për kryerjen e ndonjë vepre penale apo i dëbuar;

ç) Drejtorinë e Emigracionit në Policinë e Shtetit në rastet kur ka të dhëna për dëbime nga territori i një shteti të huaj, si dhe drejtoritë vendore për të dhëna më specifike;

d) Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, dhe ato të Apelit, si dhe në Prokurorinë e Posaçme, nëse ka, kallëzime apo referime për kryerjen e ndonjë vepre penale, ose procedime penale të regjistruara në ngarkim të personit subjekt verifikimi, masa sigurimi të caktuara, ose dënime të dhëna me vendime jopërfundimtare apo të formës së prerë ndaj tij;

dh) Gjykatat e Shkallës së Parë, dhe ato të Apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën e Shkallës së Parë dhe atë të Apelit kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, nëse ka çështje penal të shqyrtuara dhe vendime penale të dhëna ose vendime për caktim masa sigurimi personale në ngarkim të personit subjekt verifikimi;

e) Ministrinë e Drejtësisë për dënimet penale, masat e sigurimi të caktuara nga gjykata, urdhrat për kërkime ndërkombëtare;

ë) Kërkon informacion në sistemin TIMS për të dhëna mbi gjeneralitetet, identitetin fizik, kërkimet kombëtare dhe ndërkombëtare, dëbimet, etj.

f) Policinë e Shtetit për administrimin e gjurmëve daktiloskopike dhe çdo të dhëne tjetër biometrike, ose në mungesë të tyre në shoqërinë ALEAT sh.a, për nevoja të krahasimit me databazat e INTERPOL-it, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Policisë Shkencore, ku ruhen rekordet kriminale të shtetasve;

g) Kërkon depozitimin brenda 5 ditëve, nga personi i verifikuar, të të dhënave daktiloskopike dhe çdo të dhëne tjetër biometrike, në mungesë të tyre, sipas procedurave të legjislationit mbi identifikimin dhe pajisjen me dokumente identifikimi të shtetasve;

h) Në varësi me të dhënat e përftuara nga veprimet verifikuese mund të kryejë veprime verifikuese të tjera për sqarimin dhe qartësimin e rrethanave të paqarta.

2. Bazuar në gjetjet e procedurës së verifikimit, në rastet kur konkludohet se verifikimi është kryer i plotë dhe i gjithanshëm dhe/ose nuk ekzistojnë metoda apo mënyra të reja për

³³ Shih, nenin 8 pikat 5, 6, 7, 8, 9 e vijues të ligjit nr.138/2015 dhe piken 7 e vijuese të KREU-t V i vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.

realizimin e verifikimeve të tjera, si dhe vlerësohet përfundimi i këtij procesi brenda një afati 3-mujor nga momenti i ardhjes së kërkesës për verifikim, sipas rastit, oficeri i policisë gjyqësore ose specialisti jurist i disponuar, i paraqet prokurorit të deleguar, aktet/dokumentat, së bashku me një relacion shpjegues për të dhënat e verifikuara, veprimet verifikuese të kryera dhe rezultatet e tyre, si dhe mendimet/sugjerimet e veta për rrethanat apo faktet që provojnë ekzistencën e të dhënave të padeklaruara apo të deklaruara ndryshe ose që provojnë mosbashkëpunim apo refuzim për të bashkëpunuar, pengesa, vonesa apo keqdrejtim në procesin e verifikimit, nga çdo organ shtetëror apo person juridik, publik apo privat.

3. Në rastet, kur është e nevojshme që të pritet përgjigje ndaj kërkesave për verifikime të hollësishme pranë juridiksioneve të huaja, ose kur ka informacione dhe është e nevojshme që verifikimi të kryhet edhe jashtë vendit, dhe prokurori i deleguar, vlerëson se procesi i verifikimit nuk mund të përfundoj brenda afatit 3 mujor nga momenti i ardhjes së kërkesës për verifikim, ai (prokurori i deleguar) merr vendim të arsyetuar për zgjatjen e afatit të procesit të verifikimit³⁴, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar, të cilin ja paraqet për miratim, sipas rastit, shefit të sektorit të deleguar ose drejtorit të deleguar, jo më vonë se 5 ditë përpara përfundimit të afatit ligjor.

4. Gjatë ecurisë së procesit të verifikimit ose në përfundim të tij, prokurori i deleguar, në rastet kur vlerëson të nevojshme apo të domosdoshme, realizon dhe procedurat standarde si më poshtë:

a) kontrollon ecurinë e verifikimeve dhe procedurën e kryer nga oficeri i policisë gjyqësore ose specialisti jurist;

b) në rastet kur vlerëson se nuk mund të procedohet me përfundimin e procesit të verifikimit me gjendjen e akteve të verifikuara, nxjerr urdhër për kryerjen e verifikimeve të tjera, të mëtejshme;

c) dërgon shkresa standarde për kërkim informacioni dhe/ose dokumentacioni në institucionet publike dhe subjektet private, në lidhje me rrethana fakti apo kushte dhe kriteret e tjera ligjore të verifikimit.

5. Prokurori i deleguar, bazuar në gjetjet e procedurës së verifikimit të kryer, kur vlerëson se mund të procedohet me përfundimin e procesit të verifikimit, menjëherë merr vendim të arsyetuar për përfundimin e procesit të verifikimit dhe miratimin e rrezultateve të tij, i cili së bashku me të gjithë aktet e tjera i përcillet, sipas rastit, nëpërmjet shefit të sektorit të deleguar ose drejtorit të deleguar, për vlerësim dhe miratim Prokurorit të Përgjithshëm. Ndërkohë, procedon, edhe si më poshtë:

a) Vendimi i miratuar, brenda 3 ditëve nga përfundimi i verifikimit dhe miratimi i rezultateve, i njoftohet organit kompetet/përgjegjës kërkues dhe personit të verifikuar vetëm në rastet kur kërkesa për verifikim është e një partie politike³⁵.

b) Në raste kur konstatohen elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal, bazuar në nenin 5, pika 3, dhe nenin 8, pika 11, të ligjit nr.138/2015, ia kalon/dërgon aktet përkatëse për vlerësim dhe vendimarrje në prokurorinë pranë gjykatës kompetente;

c) Në rastet kur shkeljet e detyrimit për bashkëpunim gjatë procesit të verifikimit përbëjnë elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në bazë të nenit 5, pika

³⁴ Shih, pikën 9 të KREU V i vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë;

³⁵ Shih, nenet 8 e 16, pika 4 në lidhje me nenin 5 pika 4 e 7 pika 5 e vijues të ligjit nr.138/2015, dhe pikën 11 të Kreut V-së, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

6, dhe nenit 9 të ligjit nr.138/2015, aktet përkatëse i kalohen/dërgohen për vlerësim dhe vendimarrje prokurorisë pranë gjykatës kompetente.

ç) Për rastet e kaluara për kompetencë vlerësimi dhe vendimarrjeje për veprën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal, prokurori i deleguar në bashkërendim me strukturat përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme ndjek ecurinë e tyre deri në Gjykatën e Lartë, me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore nëpërmjet një vendimi njësuës ose unifikues të Gjykatës së Lartë.

d) Në përfundimet e procesit të verifikimit dhe miratimin e rezultateve të verifikimit dhe para arkivimit, kontrollon administrimin dhe inventarizimin e akteve dhe çdo dokument tjetër në dosje, si dhe verifikon saktësinë e të dhënave të hedhura në sistem nga sekretaria, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 5 të këtij udhëzimi.

Neni 10

Afatet dhe llogaritja e tyre

1. Afatet në procedurën e verifikimit të të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit caktohen në ditë kalendarike.

2. Përveç kur parashikohet ndryshe në ligj ose në këtë udhëzim, në llogaritjen e afatit përjashtohet dita kur është paraqitur kërkesa, nga e cila fillon të llogaritet afati.

3. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e dielë ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

4. Dita e fundit e afatit të kryerjes së veprimit procedural dhe verifikues, paraqitjes së kërkesave apo shpjegimeve apo çdo dokumenti apo akti, mbaron në çastin e mbarimit të orarit zyrtar.

Neni 11

Njoftimet

1. Njoftimet dhe vendimet e strukturës së posaçme në Prokurorinë e Përgjithshme drejtuar kërkuesit/organit kompetent/përgjegjës, gjatë zhvillimit të procedurës së verifikimit dhe në përfundim të saj, bëhen me shkresë, në adresën postare të deklaruar posaçërisht për këtë qëllim nga kërkuesi, ose personi i verifikuar³⁶ vetëm në rastet kur ai është kandidat i mundshëm i një partie politike.

2. Njoftimet dhe kërkesat e organeve kompetente drejtuar strukturës së posaçme në Prokurorinë e Përgjithshme bëhen me shkrim, duke i depozituar në zyrën e protokollit të Prokurorisë së Përgjithshme që i përcjell në sekretarinë e strukturës së posaçme.

3. Njoftimet, sipas rastit, të subjekteve që verifikohen (marrja e shenjave të gishtave, etj), bëhen në adresën e deklaruar prej tyre në formularin e vetëdeklarimit.

KREU IV

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE, ZBATIMI, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

³⁶ Neni 7, pika 5 e ligjit nr.138/2015;.

Neni 12
Përgjegjësia disiplinore

Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i normimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, mund të përbëjnë, shkelje disiplinore sipas ligjit³⁷ dhe/ose shkak për nisjen e verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj punonjësve të strukturës së posaçme ose prokurorit apo drejtuesit në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, sipas ligjit.

Neni 13
Zbatimi dhe mbikëqyrja

1. Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga prokurorët, shefi i seksionit dhe punonjësit e tjerë të Sektorit të Dekriminalizimit, si dhe punonjësit e strukturave të tjera të përfshira në veprimtarinë bashkërenduese me këtë sektor në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm³⁸.

2. Me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohen drejtuesi i Drejtorisë së Koordinimit Institucional³⁹ dhe drejtuesi i Seksionit të Monitorimit pranë kësaj Drejtorie në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët për ecurinë e zbatimit të këtij udhëzimi informojnë periodikisht Prokurorin e Përgjithshëm.

Neni 14
Hyrja në fuqi dhe publikimi

Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

PROKUROR I PËRGJITHSHËM

OLSIAN ÇELA



³⁷ Shih, nenin 148/d pika 1 të Kushtetutës dhe nenet 101 dhe 102 të ligjit nr.96/2016, i ndryshuar me ligjin nr.48/2019, nenet 89, 108 të ligjit nr. 97/2016 dhe nenin 33 i ligjit nr. 25/2019.

³⁸ Shih nenin 46 pika 1 dhe nenin 103 të ligjit nr.97/2016

³⁹ Shih po aty nenin 52 pika 3.